



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E lidhur me datën 13.06.2019 ne Lipjan ndërmjet:

Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson drejtorit të Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z.Adem Duriqi në njërën anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues, dhe

Emri i Kontraktuesit "Osmani Holding" SHPK-Torinë të cilin e përfaqëson Shemsie Ahmeti (në anën tjetër) në tekstin e mëtejshëm kontraktuesi.

Titulli i kontratës: Rregullimi i oxhakëve në shkollat Emin Duraku -Banulle , Skenderbeu -Kraishtë, dhe 17 Shkurti -Glllogoc 613 019 069 536

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Rregullimi i oxhakëve në shkollat Emin Duraku -Banulle , Skenderbeu -Kraishtë, dhe 17 Shkurti -Glllogoc

1.2 Kontrata hyn në fuqi prej datës së nënshkrimit, plani dinamik nuk duhet të jetë më i gjatë se 20 ditë nga hapja e ditarit të punës dhe çdo vonesë pa arsye më gjatë se plani dinamik i ofertuar do të konsiderohet shkelje i kontratës dhe do të zbatohen penalet.

Me fillimin e punëve do hapet ditar i punës në terren duhet të jetë çdo herë inxhinieri cili do ta nënshkruan ditarin së bashku me menaxherin e caktuar nga autoriteti , punimet do të kryhen sipas parametres e cila është pjesë e kësaj dosje të tenderit kontraktues.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jenë shkollat: Emin Duraku -Banulle , Skenderbeu -Kraishtë, dhe 17 Shkurti -Glllogoc

1.5 Incotermin i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi përgjithshëm për kryerjen e shërbimeve mirëmbajtja parqeve në qytetin e Lipjanit shprehur në shifra është 2419.50€. Me fjalë (dymije e katerqind e nentembdhjete /euro/e pesëdhjetë

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

/centë)

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borbh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesat do të bëhen: *Pagesa do të kryhet pas kryerjes së puneve në bazë të raportit nga menaxheri i kontratës se janë kryer me sukses dhe nuk ka vërejtje në punet e kryera.*

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Kërkesat e garantimit: - Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[punëve]*.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të *realizojë ndonjë ose të gjitha punëve* brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *Punëve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, e puneve të kryera që, në mënyrë që të përcaktojë nëse punet e **Rregullimi i oxhakëve në shkollat Emin Duraku -Banulle , Skenderbeu -Kraishtë, dhe 17 Shkurti -Gllëgoc** të kanë cilësinë dhe-sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 18 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Shemsie Ahmeti	Emri:	Daut Reqica
Pozita:	Per Ahmeti	Pozita:	UD
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14-06-2019	Data:	14-06-2019
Vula:	OSMANI HOLDING SH.P.K. TORINË-LIPJAN	Vula:	

PARAMASA & PARALLOGARJA PËR RREGULLIMIN E OXHAKUT NË SHKOLLËN „SKENDERBEU”,
KRAISHTË

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi njësi	Shuma
1	Gërmimi i dheut, hapja e bazamentit për oxhak me dim. 100 x 100 thellësia 50 cm	m ³	0.7	20.00	14.00

2	Furnizimi dhe shtruarja me zhavor 0 - 31.5 mm nën beton, zhavori me trashësi T = 15 cm, në çmime të llogaritet edhe ngjeshja	m ³	0.15	30.00	4.50
3	Armimi dhe Betonimi i Bazamentit të oxhakut, dimensionet e oxhakut 100 x 100 x 10 cm, paguhet me m ³ , në çmim të llogaritet edhe armimi	m ³	1	50.00	50.00
4	Murosja e Oxhakut me tulla prej argjilës (tulla me qëndrueshmëri të lart ndaj temperaturave të larta) dhe me materiale të nevojshme për murosje , me dim. 50 x 50 cm Lartësia h 9.5 m, në çmim të llogariten edhe skelet	m'	9.5	50.00	475.00
5	Suvatimi i oxhakut të ri, me dim. 50 x 50 cm Lartësia h 11 m	Copë	1	100.00	100.00
6	Furnizimi dhe montimi i Qyngës fi 300-1000 cm	Copë	1	50.00	50.00
7	Demolimi i oxhakut të vjetër (në paramasë të llogaritet edhe zëgjirimi i hapsirës në pllakat e objektit sa janë dimensionet e oxhakut	Copë	1	100.00	100.00
8	Lidhja me armature qelik fi 12 e oxhakut me shtyllat e objektit (oxhaku duhet të lidhet së paku në tre vende)	Copë	1	20.00	20.00
Totali 1					813.00

PARAMASA & PARALLOGARIA PËR RREGULLIMIN E OXHAKUT NË SHKOLLËN „EMIN DURAKU,,
BANULLË

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi njësi	Shuma
1	Gërmimi i dheut, hapja e bazamentit për oxhak me dim. 100 x 100 thellësia 50 cm	m ³	0.7	20.00	14.00
2	Furnizimi dhe shtruarja me zhavor 0 - 31.5 mm nën beton, zhavori me trashësi T = 15 cm, në çmime të llogaritet edhe ngjeshja	m ³	0.15	30.00	4.50
3	Armimi dhe Betonimi i Bazamentit të oxhakut, dimensionet e oxhakut 100 x 100 x 10 cm, paguhet me m ³ , në çmim të llogaritet edhe armimi	m ³	1	100.00	100.00
4	Murosja e Oxhakut me tulla prej argjilës (tulla me qëndrueshmëri të lart ndaj temperaturave të larta) dhe me materiale të nevojshme për murosje , me dim. 50 x 50 cm Lartësia h 11 m, në çmim të llogariten edhe skelet	m'	11	50.00	550.00
5	Suvatimi i oxhakut të ri, me dim. 50 x 50 cm Lartësia h 11 m	Copë	1	100.00	100.00
6	Furnizimi dhe montimi i Qyngës fi 300-1000 cm	Copë	1	50.00	50.00

7	Demolimi i oxhakut të vjetër (në paramasë të llogaritet edhe zëgjirimi i hapsirës në pllakat e objektit sa janë dimensionet e oxhakut	Copë	1	100.00	100.00
8	Lidhja me armaturë qelik Ø 12 e oxhakut me shtyllat e objektit (oxhaku duhet të lidhet së paku në tre vende)	Copë	1	20.00	20.00
Totali 2					938.50

PARAMASA & PARALLOGARIA PËR RREGULLIMIN E OXHAKUT NË SHKOLLËN „17 SHKURTI,,
GLLOGOVÇ

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi njësi	Shuma
1	Gërmimi i dheut, hapja e bazamentit për oxhak me dim. 100 x 100 thellësia 50 cm	m ³	0.7	50.00	35.00
2	Furnizimi dhe shtruarja me zhavor 0 - 31.5 mm nën beton, zhavori me trashësi T = 15 cm, në çmime të llogaritet edhe ngjeshja	m ³	0.15	50.00	7.50
3	Armimi dhe Betonimi i Bazamentit të oxhakut, dimensionet e oxhakut 100 x 100 x 10 cm, paguhet me m ³ , në çmim të llogaritet edhe armimi	m ³	1	100.00	100.00
4	Murosja e Oxhakut me tulla prej argjilës (tulla me qendrueshmeri te lart ndaj tmperaturave te larta) dhe me materiale të nevojshme për murosje , me dim. 50 x 50 cm Lartësia h 9.5 m, në çmim të llogariten edhe skelet	m'	9.5	50.00	475.00
5	Furnizimi dhe montimi i Qyngës fi 300-1000'cm	Copë	1	50.00	50.00
					667.50
Totali 3					2419.50